



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3033 Prot.

Tiranë, më 06/10/2023

**Lënda:** Kërkesë për marrjen e masës disiplinore

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

**Baza Ligjore:** Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.  
Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

*E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,*

Lidhur me situatën e krijuar pas mbylljes së diskutimeve në seancën plenare të datës 05.10.2023, ku deputetë të caktuar të opozitës me sjelljet e tyre thyen Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, duke penguar zhvillimin normal të seancës plenare, shprehemi të keqardhur nga situata e papranueshme, e paprecedentë në shkelje të parimeve të parlamentarizmit dhe normave etike të sjelljes shkaktuar nga deputetë të opozitës.

Përkatësisht deputetët Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati dhe Zheni Gjergji bllokuan vendin në sallën e seancës plenare, ku ulet Kryetarja e Kuvendit, duke penguar që të vijonte normalisht seanca plenare, pas mbylljes së diskutimeve.

Deputetët Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi në koordinim me njëri-tjetrin penguan korridorin hyrës të Kryetares së Kuvendit në sallën e seancës plenare, me karrige si dhe nuk lejuan kalimin e saj drejt vendit të saj, për të njoftuar vijimin ose mbylljen e seancës plenare sipas kompetencave që i njej ligji dhe Rregullorja e Kuvendit.

Deputeti Gazmend Bardhi e pengoi Kryetaren që të jepte njoftimet duke i hequr kartën nga pajisja elektronike gjatë fjalës së saj që po mbante në një nga vendet ulëse të Këshillit të Ministrave, në pamundësi që të fliste nga vendi i saj si pasojë e bllokimit nga deputetë të opozitës siç përshkruhet më sipër.

Të gjitha veprimet e mësipërme, përbëjnë shkelje të rënda sipas Rregullores së Kuvendit, neni 65/1, pika 'a', (pengimi i seancës plenare, shkaktim kaosi) dhe që vijnë në kundërshtim të hapur me Kodin e Sjelljes së Deputetit, pasi përbëjnë veprime të papërgjeshme, kundër normave etike për deputetin si model për shoqërinë dhe që çënojnë rëndë imazhin e Kuvendit dhe vetë deputetit në publik.

***Për sa më sipër paraqesim këtë kërkesë për:***


- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, sipas nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe pika 4, dhe neni 63, pika 1 gërma d), të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit, neni 3, pika dh) dhe ë) dhe nenin 8, pika 2, gërma b) dhe neni 33.


- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin dhe marrjen e masës disiplinore që kërkohet nga deputetët.


Gledes Lera 

TONT GORU 

ESUARD SUAN 

Arben Cellums 

Neerit 

SAMIR HASILCA 

ETJEN XIATAJ 